

RAPORT VLERËSUES LLOGARIDHËNIA SOCIALE DHE PJESËMARRJA E FËMIJËVE



NGOM MU!

RAPORT VLERËSUES

LLOGARIDHËNIA SOCIALE DHE

PJESËMARRJA E FËMIJËVE

NGOM MU!

Autore:

PhD Candidate - Zana Shabani

Ky raport u mundësua në kuadër të projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë” i cili implementohet nga HANDIKOS në partneritet me Save dhe Children in Kosovo, dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e HANDIKOS dhe nuk pasqyron me doemos pikëpamjet e donatorit.



PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	6
Përmbledhje ekzekutive.....	7
1. Hyrje	9
1.1 Sfondi	10
1.2 Përshkrimi i projektit	10
1.3 Llogaridhënia Sociale- Fletënotimi Komunitar	13
1.4 Pjesëmarrja kuptimplote e fëmijëve me AK në procese vendimmarrëse	14
2. Qëllimi i vlerësimit, audienca, objektivat dhe fushëveprimi	16
2.1 Qëllimi kryesor i vlerësimit	17
2.2 Audienca	17
2.3 Objektivat e vlerësimit	17
2.4 Pyetjet kërkimore	18
3. Metodologjia	19
3.1 Mostra e pjesëmarrësve.....	21
3.1 Mbledhja e të dhënave, procesimi dhe analiza	21
4. Të gjeturat kryesore	24
5. Kufizimet	45
6. Rekomandimet.....	47
7. Anekset	50



LISTA E SHKURTESAVE

AK- Aftësi e Kufizuar

Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar- SIDA

GA- Grup Avokues

GA-FAK- Grupi Avokues i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara

FAK- Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

FK- Fletënotimi Komunitar

Save the Children në Kosovë- SCiK

OSHC- Organizatat e Shoqërisë Civile



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

HANDIKOS është fuqimisht i përkushtuar për të adresuar nevojat e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes koordinimit dhe qasjes holistike të nevojshme, me qëllim të integritetit të aftësisë së kufizuar në të gjithë legjislacionin, politikat dhe strategjitë për të luftuar dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset. Nga viti 2017-2021, HANDIKOS ka implementuar projektin “Promovimi i parandalimit të dhunës në të gjitha mjediset për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë” në partneritet me Save the Children në Kosovë dhe me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar. Projekti synon promovimin dhe adresimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) përmes përmirësimit të koordinimit ndërsektorial dhe promovimit të masave gjithëpërfshirëse për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe pa ndëshkim fizik dhe poshtërues (NFP) për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë dhe synuar të gjithë akterët që luajnë rol në jetën e një fëmije – nga familjet, moshatarët dhe përfaqësuesit e tyre, komunitetet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët dhe institucionet e deri tek publiku i gjerë. HANDIKOS synon të arrijë këtë qëllim, përmes përmbyshjes së dy objektivave të këtij projekti:

1. Përmirësimi i cilësisë së politikave dhe praktikave të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe rritja e ndërgjegjësimit, njohurive dhe bashkëpunimit ndërsektorial midis komuniteteve dhe ofruesve të shërbimeve për të parandaluar dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset. Përmes kësaj objektive¹, HANDIKOS ka synuar të mbrojë fëmijët me AK nga dhuna, ngacmimet dhe format e tjera të viktimizimit përmes programeve ndërgjegjëse dhe rritjes së kapaciteteve të të gjithë akterëve kyç në jetën e fëmijëve si: Programi i Disiplinës Pozitive për prindër; Ligjërata mbi parandalimin e diskriminimit, paragjyqimeve dhe stereotipeve ndaj personave me AK për bashkëmoshatarët; Sesione informuese mbi teknikat e komunikimit dhe specifikat e fëmijëve me AK në Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, për ofruesit e shërbimeve; si dhe Programi trajnues për parandalimin e dhunës për vetë fëmijët me aftësi të kufizuara.

¹Impakti i kësaj objektive është i reflektuar në dokumente tjera të HANDIKOS.



2. Promovimi i llogaridhënies sociale me fokus tek fëmijët, pjesëmarrjes së tyre për përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe adekuata për ta. Në kuadër të objektivës së dytë të këtij projekti, HANDIKOS ka synuar të inkurajojë zgjidhjen e problemeve lokale, duke fuqizuar bartësit e të drejtave dhe përdoruesit e shërbimeve (fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre) për të ndarë pikëpamjet dhe përshtypjet e tyre me ofruesit e shërbimeve përmes përfshirjes së tyre në proceset e llogaridhënies sociale, përkatësisht në procesin e Fletënotimit Komunitar. Gjithashtu, në kuadër të kësaj objektive HANDIKOS ka synuar të mbështes dhe fuqizoj grupin avokues të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të avokuar lidhur me çështjet që i preokupojnë ata si dhe për të marrë pjesë në mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve. HANDIKOS përmes këtij raporti vlerësues synon të paraqes impaktin e zbatimit të projektit tek përfituesit direkt, që janë fëmijët me aftësi të kufizuara (AK), prindërit e fëmijëve me AK si dhe ofruesit e shërbimeve dhe palët e tjera të interesit. Ky vlerësim ka aplikuar një metodologji të kombinuar të shqyrtimit të të dhënave sekondare dhe mbledhjes së të dhënave primare. Në përgjithësi, impakti i objektivës së dytë specifikisht ka qenë pozitiv dhe në nivelin e duhur për të arritur vendosjen e bashkëpunimit dhe dialogut në mes të shfrytëzuesve të shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve. Me anë të aktiviteteve të kësaj objektive jo vetëm që është arritur përmirësimi i shërbimeve për fëmijët me AK, si dhe bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve, por në masë të madhe është rritur edhe vetëdijësimi dhe mobilizimi i fëmijëve për të ngritur zërin dhe avokuar për çështjet që i shqetësojnë ata si dhe për të qenë pjesë e vendim-marrjes.

Rekomandohet fuqishëm që projektet e tilla të zgjerohen edhe në komuna dhe institucione tjera, për të vetëdijësuar më tutje komunitetet dhe ofruesit e shërbimeve si dhe për të përmirësuar shërbimet për fëmijët me AK në nivel vendi.



HYRJE

1.1 SFONDI

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) me qëllim të vlerësimit të impaktit në kuadër të projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës në të gjitha mjediset për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë”, ka realizuar këtë raport përmbledhës të punës 5 vjeçare të organizatës në fushën e llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve. Pra, ky raport synon të paraqes impaktin e zbatimit të projektit dhe llogaridhënien ndaj donatorëve të projektit dhe përfituesve, duke u fokusuar në objektivin e dytë të projektit: “Promovimi i llogaridhënies sociale me fokus tek fëmijët, pjesëmarrjes së fëmijëve për përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe adekuate për ta”.

1.2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Realizimi i të drejtave të fëmijëve dhe pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara (FAK), vazhdon të mbetet problematikë dhe të mos trajtohet me prioritet nga institucionet relevante dhe komuniteti i gjerë. Për më tepër, shpesh informacioni për nevojat nuk është i kënaqshëm dhe mungesa e burimeve dhe kompetencave ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Megjithatë, nevojitet ende shumë për të punuar në krijimin e sistemeve më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve, zhvillimin e mjeteve të duhura monitoruese, shpërndarjen adekuatë të burimeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe politik për mbrojtjen e FAK.²

Me mbështetjen e Save the Children në Kosovë (SCiK), HANDIKOS ka implementuar projektin “Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë” nga viti 2017 deri në vitin 2021. Projekti synon promovimin dhe adresimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) përmes përmirësimit të koordinimit ndërsektorial dhe promovimit të masave gjithëpërfshirëse

²Projekt Propozimi HANDIKOS, 2021



për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe pa ndëshkim fizik dhe poshtërues (NFP) për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë dhe synuar të gjithë akterët që luajnë një rol në jetën e një fëmije – nga familjet, moshatarët dhe përfaqësuesit e tyre, komunitetet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët dhe institucionet e deri tek publiku i gjerë. HANDIKOS synon të arrijë këtë qëllim, përmes përmbushjes së dy objektivave të këtij projekti:

1. Përmirësimi i cilësisë së politikave dhe praktikave të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe rritja e ndërgjegjësimit, njohurive dhe bashkëpunimit ndërsektorial midis komuniteteve dhe ofruesve të shërbimeve për të parandaluar dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset. Përmes kësaj objekte, HANDIKOS ka synuar të mbrojë fëmijët me AK nga dhuna, ngacmimet dhe format e tjera të viktimizimit përmes programeve ndërgjegjësuere dhe rritjes së kapaciteteve të të gjithë akterëve kyç në jetën e fëmijëve si: Programi i Disiplinës Pozitive për prindër; Ligjërata mbi parandalimin e diskriminimit, paragjyqimeve dhe stereotipeve ndaj personave me AK për bashkëmoshatarët; Sesione informuese mbi teknikat e komunikimit dhe specifikat e fëmijëve me AK në Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, për ofruesit e shërbimeve; si dhe Programi trajnues për parandalimin e dhunës për vetë fëmijët me aftësi të kufizuara.
2. Promovimi i llogaridhënies sociale me fokus tek fëmijët, pjesëmarrjes së tyre për përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe adekuate për ta. Në kuadër të objektivës së dytë të këtij projekti, HANDIKOS ka synuar të inkurajojë zgjidhjen e problemeve lokale, duke fuqizuar bartësit e të drejtave dhe përdoruesit e shërbimeve (fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre) për të ndarë pikëpamjet dhe përshtypjet e tyre me ofruesit e shërbimeve përmes përfshirjes së tyre në proceset e llogaridhënies sociale, përkatësisht në procesin e Fletënotimit Komunitar. Për këtë qëllim, Fletënotimi Komunitar (FK) është përdorur për të marrë përshtypjet nga përfituesit e shërbimeve dhe për të përmirësuar komunikimin mes tyre dhe ofruesve të shërbimeve. FK është realizuar në intervale të rregullta çdo vit për të monitoruar performancën dhe identifikuar mënyra të tjera të përmirësimit të performancës së ofrimit të shërbimeve.



Gjithashtu, në kuadër të kësaj objektive HANDIKOS ka synuar të mbështes dhe fuqizoj grupin avokues të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të avokuar lidhur me të drejtat e tyre si dhe për të marrë pjesë në mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve. Kjo është realizuar fillimisht përmes krijimit dhe funksionalizimit të grupit avokues “Hëna” të udhëhequr nga fëmijët me AK dhe në vazhdimësi mbështetjes dhe fuqizimit të kapaciteteve të tyre në mekanizma të pjesëmarrjes si dhe të aktiviteteve avokuese, me qëllim të përmirësimit dhe monitorimit të shërbimeve. HANDIKOS përmes këtij raporti vlerësues synon të paraqes impaktin e zbatimit të projektit tek përfituesit direkt, që janë fëmijët me aftësi të kufizuara (AK), prindërit e fëmijëve me AK si dhe ofruesit e shërbimeve dhe palët e tjera të interesit. Objektiva e dytë e cila njëkohësisht është fokus i këtij vlerësimi, ka pasur për qëllim të arrijë katër rezultate kyçe të programit:

1. Praktikrat e dialogut të llogaridhënies sociale të përdorura për të përmirësuar qasjen në shërbime cilësore të mbrojtjes së fëmijëve: Promovimi i llogaridhënies sociale – Fletënotimi Komunitar;

2.2.a Organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) dhe Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi (QRBB) kanë kapacitete për të përdorur dhe promovuar mjetet e llogaridhënies sociale për të mundësuar krijimin e sistemeve të përgjegjshme të cilat marrin në konsideratë prioritetet e fëmijëve;

2.2.b Fëmijët, familjet dhe ofruesit e shërbimeve kuptojnë dhe marrin pjesë aktive në dialogun e llogaridhënies sociale).

3. Grupet e Udhëhequra nga Fëmijët kanë kapacitete që mundësojnë pjesëmarrjen e tyre kuptimplote në proceset vendimmarrëse – Fuqizimi i Grupeve Avokuese të Udhëhequra nga FAK (GAFAK) – HËNA.



1.3 LLOGARIDHËNIA SOCIALE- FLETËNOTIMI KOMUNITAR

Llogaridhënia sociale është një qasje që mbështetet në angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë ose tërthortë në kërkimin e llogaridhënies nga ofruesit e shërbimeve dhe zyrtarët publikë^{3,4}. FK është mjet i llogaridhënies sociale i drejtuar nga qytetarët që rrit përfshirjen dhe zërin e qytetarëve dhe plotëson mekanizmat konvencional të llogaridhënies nga ana e ofruesve të shërbimeve, të tilla si kontrollet dhe balancat politike, sistemet e kontabilitetit dhe auditimit, rregullat administrative dhe procedurat ligjore⁵. Duke vendosur llogaridhënie dhe bashkëpërgjegjësi të ndërsjellë të qytetarëve dhe qeverive të tyre, mjetet e llogaridhënies sociale u tregojnë qytetarëve se ata mund të luajnë një rol kritik në përmirësimin e shërbimeve që pranojnë. Përmes fokus grupeve dhe takimeve të përbashkëta të facilituara, procesi i FK ju ofron përdoruesve të shërbimit mundësinë për të dhënë informacione sistematike dhe konstruktive ofruesve të shërbimeve për performancën e tyre⁶. Ai gjithashtu ua mundëson ofruesve të shërbimeve të mësojnë drejtpërdrejt nga komuniteti se cilat aspekte të shërbimeve dhe programeve të tyre funksionojnë mirë dhe cilat aspekte kanë nevojë për përmirësim⁷. Në kuadër të iniciativave për të përmirësuar shërbimet që u ofrohen fëmijëve me AK, deri vonë nuk janë praktikuar mekanizma të tillë të llogaridhënies sociale, që involvojnë fëmijët me AK, prindërit apo kujdestarët e tyre ligjorë dhe ofruesit e shërbimeve, ndaj implementimi i këtij instrumenti nga HANDIKOS është praktikë e re në Kosovë.

³ https://www.unicef.org/sites/default/files/2019-12/Social_Accountability_stocktake.pdf

⁴ https://www.unicef.org/sites/default/files/2019-12/Social_Accountability_stocktake.pdf

⁵ <https://www.care.org/news-and-stories/resources/the-community-score-card-csc-toolkit/>

⁶ https://www.civicus.org/documents/toolkits/PGX_H_Community%20Score%20Cards.pdf

⁷ <http://familyplanning.care2share.wikispaces.net/>



1.4 PJESËMARRJA KUPTIMPLOTE E FËMIJËVE ME AK NË PROCESE VENDIMMARRËSE

Përfshirja dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në procese vendimmarrëse është e rëndësishë së veçantë duke i mundësuar fëmijëve që të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre në vendime që kanë të bëjnë me shërbimet që u ofrohen⁸. Parimi i pjesëmarrjes së fëmijëve theksohet në nenin 12 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), e cila njeh të drejtën e fëmijëve të përfshihen në vendimet që i prekin në përputhje me kapacitetet e tyre në zhvillim⁹. Për shumicën e fëmijëve me AK nuk realizohet e drejta për tu dëgjuar dhe konsideruar seriozisht mendimet dhe pikëpamjet e tyre.

Para intervenimeve të këtij projekti, fëmijët me aftësi të kufizuara rrallë-herë janë përfshirë në iniciativa të tilla dinamike si forume rinore, parlamente për fëmijë, edukim të bashkëmoshatarëve ose projekte mediatike dhe as nuk janë përfshirë në fushata për realizimin e të drejtave, apo konsultime në hulumtime relevante. KDF thekson dhe kërkon në mënyrë eksplicite që qeveritë e vendeve në mënyrë aktive dhe në vazhdimësi të konsultojnë fëmijët me AK përmes organizatave të tyre përfaqësuese, gjatë hartimit dhe implementimit të programeve dhe politikave me qëllim të realizimit të të drejtave¹⁰. Ndonëse në Kosovë, ekzistojnë korniza ligjore dhe strategji që e mbulojnë fushën e pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në procese vendimmarrëse si Ligji për mbrojtjen e fëmijës LIGJI NR. 06/L-084, neni 46 “Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijës me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikë bërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijës për të kuptuar”, situata në realitet paraqet një mungesë të theksuar të pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në procese vendimmarrëse¹¹.

⁸ <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40542-UpdEn.pdf>

⁹ www.hants.gov.uk/rh/comm/

¹⁰ https://sites.unicef.org/disabilities/files/Take_Us_Seriously.pdf

¹¹ <http://hk.adxpositive.com/category/projektet/>



Me qëllim të realizimit të të drejtës së pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në procese vendimmarrëse dhe në mekanizma të llogaridhënies sociale që synim kanë përmirësimin dhe monitorimin e shërbimeve që u ofrohen fëmijëve me AK, duke konsideruar kërkesat dhe nevojat e tyre, HANDIKOS në kuadër të objektivës së dytë të projektit 5 vjeçar (2017-2021) ka intervenuar në :

- Inkurajimin e zgjidhjes së problemeve lokale përmes përfshirjes së fëmijëve në procese të llogaridhënies sociale;
- Krijimin dhe funksionalizimin e grupeve avokuese të udhëhequra nga fëmijët me AK;
- Mbështetjen e iniciativave avokuese të udhëhequra nga fëmijët me AK për të monitoruar dhe avokuar për shërbime të përmirësuara dhe qeverisje të të drejtave të fëmijëve me AK;
- Ndërtimin e kapaciteteve për pjesëmarrje në proceset e reformave ligjore;
- Vetëdijësimin për të drejtat e fëmijëve me AK;
- Përmirësimin e komunikimit dhe vendosjes së frymës së bashkëpunimit në mes të ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve.



**QËLLIMI I VLERËSIMIT,
AUDIENCA, OBJEKTIVAT
DHE FUSHËVEPRIMI**

2.1 QËLLIMI KRYESOR I VLERËSIMIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti vlerësues është të paraqes impaktin e punës 5 vjeçare të HANDIKOS në fushën e llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve. Pra, ky raport synon të paraqes impaktin e zbatimit të projektit dhe llogaridhënien ndaj donatorëve, përfituesve, institucioneve dhe komunitetit, me fokus në objektivin e dytë të projektit: "Promovimi i llogaridhënies sociale me fokus tek fëmijët, pjesëmarrjes së tyre për përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe adekuate për ta."

2.2 AUDIENCA

Audienca kryesore për këtë raport janë komuniteti (fëmijët me AK dhe prindërit /kujdestarët ligjorë të fëmijëve me AK), organizatat e personave më aftësi të kufizuara, ofruesit e shërbimeve në nivel lokal dhe qendror, politikëbërësit dhe donatorët si dhe palët e tjera të interesit në mbrojtjen e fëmijëve me AK dhe promovimin e të drejtave të tyre.

2.3 OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT

- Vlerësimi i impaktit të HANDIKOS në fushën e llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve;
- Ofrimi i rekomandimeve në qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura, duke përfshirë këtu edhe akterët të cilët kontribuan në arritjen e këtyre rezultateve si dhe në mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi;
- Nxjerrja e mësimave nga implementimi dhe përmirësimi i programeve të mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.



2.4 PYETJET E VLERËSIMIT


1. Çfarë ndikimi ka pasur projekti në përmirësimin e shërbimeve përmes implementimit të procesit të llogaridhënies sociale dhe intervenimeve avokuese?
2. Çfarë ndikimi ka pasur mekanizmi i FK në fuqizim të komunitetit dhe ofruesve të shërbimit?
3. Si kanë ndikuar intervenimet e projektit në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në proceset e vendimmarrjes dhe fuqizimin e rolit të tyre në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
4. Sa të qëndrueshme janë aktivitetet e FK dhe pjesëmarrjes së fëmijëve me AK?
5. Çfarë mësimesh i ofron përvoja e projektit të palët e interesuara?



METODOLOGIA

Ky vlerësim i impaktit ka përdorur një dizajn të metodës së kombinuar të hulumtimit. Qëllimi i hulumtimit me metoda të kombinuara synon të nxjerrë aspektet pozitive të të dy paradigmatve të kërkimit për t’iu përgjigjur më mirë pyetjeve kërkimore. Hulumtimi përmes këtyre metodave ka trianguluar njohuritë nga analiza e të dhënave sekondare nga raportet, të dhënat kualitative primare dhe krahasimin me vlerësimin fillestar, të marra nga një mostër përfaqësuese e fëmijëve, prindërve dhe akterët e mbrojtjes së fëmijëve për t’iu përgjigjur pyetjeve të vlerësimit.

Vlerësimi ka përfshirë institucionet e arsimit, shëndetësisë dhe ato sociale, komunitetin si dhe stafin në katër komunat target (të rrumbullaksuara në ngjyrë blu) Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Ferizaj.



3.1 MOSTRA E PJESËMARRËSVE

Komuna	Prishtinë		Ferizaj		Gjakovë		Mitrovicë		Total
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Fëmijët	1		1		1	2	1	2	8
Prindërit		1						2	3
Shkollat		2			1	1	1	1	6
QKMF	1								1
QPS	2						1		3
Stafi		2		1	1		1		5
Total	4	5	1	1	3	3	4	5	26

3.1 MBLEDHJA E TË DHËNAVE, PROCESIMI DHE ANALIZA

Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes:

1. Rishikimit dhe krahasimit të literaturës dhe materialeve përkatëse (duke përfshirë projekt propozimet, raportet dhe të arriturat, vlerësimin fillestar);
2. Intervistave kryesore informative;
3. Diskutimeve me fokus grupe;
4. Validimi i të dhënave me stafin.



Instrumentet/mjetet për mbledhjen e të dhënave

■ Intervista gjysmë të strukturuar

Intervista gjysmë të strukturuar janë zhvilluar me informatorët kryesorë në sektorin e shëndetësisë dhe atë të shërbimeve sociale. Përmes këtyre intervistave janë mbledhur informata rreth impaktit të FK, pjesëmarrjes së fëmijëve, pranimit të këtij koncepti nga ana e ofruesve të shërbimeve dhe mënyrën se si e shohin këtë bashkëpunim të dyanshëm. Një qasje e tillë ka mundësuar që të shtjellohen edhe çështje të tjera relevante me objektivën e vlerësimit (shih Annex B).

■ Fokus grup me fëmijët e grupit “Hëna”

Fokus grupi është zhvilluar me anëtarët e Grupit Hëna me qëllim të identifikimit të qëndrimeve të fëmijëve me AK rreth impaktit të projektit në jetën e tyre, me fokus në përmirësimin direkt të shërbimeve, dëgjimin e zërit të tyre për çështje që ata i kanë preokupuar, si dhe për mënyrën e përfshirjes në procese vendimmarrëse. Një qasje e tillë ka bërë që të kuptohet opinioni i shumicës rreth impaktit të projektit dhe përfshirjes së fëmijëve në procese avokuese dhe vendimmarrëse (shih Annex A).

■ Fokus grup me prindërit

Fokus grupi është zhvilluar me prindërit e fëmijëve me AK, me qëllim të marrjes së përshtypjeve të tyre rreth përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje. Përmes këtij fokus grupi janë marrë informata lidhur me impaktin e projektit në përmirësim të shërbimeve për fëmijët, pjesëmarrjen në procese të tilla, si dhe fuqizimin e fëmijëve dhe vetë prindërve në ngritjen e zërit dhe rritjen e pjesëmarrjes në procese vendimmarrëse.

■ Fokus grup me pjesëmarrësit nga sektori i arsimit

Fokus grupi me drejtorët e shkollave, mësuesit mbështetës, mësuesit klasor dhe psikologët në shkolla, ka pasur për qëllim identifikimin e opinioneve të tyre si ofrues të shërbimeve rreth benefiteve të FK dhe impaktit të këtij procesi në bashkëpunimin me fëmijë dhe prindër të fëmijëve me AK, si dhe në përmirësimin e shërbimeve dhe pjesëmarrjen e fëmijëve me AK.



■ Fokus grup me stafin e HANDIKOS

Është zhvilluar fokus grup me stafin e HANDIKOS të përfshirë direkt në implementimin e projektit. Me anë të këtij fokus grupi janë mbledhur informata mbi atë se çfarë stafi sheh si arritjen më të madhe të projektit, qëndrueshmërinë e projektit, sfidat dhe ecurinë e zhvillimit të aktiviteteve, si ato të FK dhe pjesëmarrjes së fëmijëve me AK si dhe ato të iniciativave avokuese.

Seksioni në vazhdim paraqet një pasqyrë të përgjithshme të implementimit të projektit dhe është i rëndësishëm për të siguruar njohuri të mjaftueshme për lexuesin për të kontekstualizuar të gjeturat e vlerësimit.

Pjesa tjetër e këtij seksioni i përgjigjet pyetjeve të vlerësimit duke u fokusuar në atë nëse FK dhe pjesëmarrja e fëmijëve kanë bërë diferencën e identifikuar në kornizën logjike.



GJETJET

1. ÇFARË NDIKIMI KA PASUR PROJEKTI NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE PËRMES IMPLEMENTIMIT TË PROCESIT TË LLOGARIDHËNIES SOCIALE DHE INTERVENIMEVE AVOKUESE?

Rezultati 2.1 Praktikatat e dialogut të llogaridhënies sociale të përdorura për të përmirësuar qasjen në shërbime cilësore të mbrojtjes së fëmijëve: Promovimi i llogaridhënies sociale – Fletënotimi Komunitar

Indikatori i Rezultatit 2.1	Po (sipas vlerësimit përfundimtar dhe raporteve)	Jo (sipas vlerësimit përfundimtar dhe raporteve))
# i ofruesve të shërbimeve, prindërve dhe fëmijëve që kontribuojnë në dialogun e llogaridhënies sociale	✓	
# veprimeve të ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve për të përmirësuar përgjegjshmërinë ndaj fëmijëve (qytetarëve dhe shoqërisë civile)	✓	
# veprimeve të ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve për të përmirësuar shërbimet e ofruara për fëmijët si rezultat i aktiviteteve të llogaridhënies	✓	
# numri i planeve të veprimit të zhvilluara	✓	

Me anë të këtij rezultati HANDIKOS ka synuar të inkurajojë përdorimin e mekanizmave të llogaridhënies sociale nga ana e bartësve të të drejtave dhe përdoruesve të shërbimeve (fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre) si dhe ofruesve të shërbimeve me qëllim të identifikimit dhe adresimit të problemeve apo përmirësimit të shërbimeve përmes dialogut të përbashkët dhe planifikimeve të përbashkëta drejt përmirësimit. Përmes vlerësimit të këtij rezultati synohet të kuptohet se si kanë ndikuar praktikatat e llogaridhënies sociale në përmirësimin e shërbimeve për fëmijët me AK.



Në vitin 2017, për herë të parë është prezantuar FK në tri komunat e targetuara nga projekti: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë. Si koncept i ri për kontekstin e Kosovës dhe palët e interesit, gjatë vitit të parë të implementimit, fillimisht është prezantuar FK, koncepti, qëllimi tij, përgatitja e pjesëmarrësve në FK dhe familjarizimi me këtë proces. Gjatë këtij viti po ashtu janë realizuar të gjitha fazat e FK dhe janë finalizuar planet e veprimit. FK është realizuar në fushën e arsimit dhe ka përfshirë shkollat: “Ismail Qemali” (Prishtinë), “Zekeria Rexha” (Gjakovë) dhe “Ahmet Hoxha” (Ferizaj). Në procesin e FK dhe zhvillimin e planeve të veprimit në fushën e arsimit kanë qenë të përfshirë: ofruesit e shërbimeve (DKA, drejtoritë e shkollës, stafi i shkollave) dhe komuniteti (përfaqësuesit e DPO-ve, Grupi Avokues i Prindërve dhe Grupi Avokuese i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Hëna). Ndërkaq, në komunën e Mitrovicës për herë të parë procesi i FK ka filluar të zbatohet në vitin 2018, në qendrën burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Terezë”.

Rezultatet kryesore të FK në sektorin e arsimit I

- Shndërrimi i dy klasave të bashkangjitura (Ferizaj dhe Gjakovë) në klasa burimore (Shih Annex D)
- Ndërtimi i tualetit të qasshëm për fëmijët me AK në SHFMU “Ismail Qemali” nga vetë fëmijët e grupit Hëna (Shih Annex D)
- Transferimi i fëmijëve me AK nga klasa e bashkangjitur në klasë të rregullt
- Hartimi planeve individuale të arsimit (PIA) për të gjithë fëmijët me AK
- Sigurimi i transportit shtëpi-shkollë dhe anasjelltas për fëmijët me AK dhe jo vetëm
- Informimi i stafit dhe prindërve mbi të drejtat dhe shërbimet për fëmijët me AK
- Trajnimi i mësuesve mbi hartimin e PIA
- Referimi i fëmijëve dhe vlerësimi nga ana e ekipeve vlerësuese komunale
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve të rregullta dhe atyre mbështetëse
- Transformimi i shkollës speciale në qendër burimore
- Rritja e frekuencës së mbështetjes së fëmijëve në shkolla të rregullta nga mësueset udhëtuese
- Funkcionalizimi i kuzhinës dhe përmirësimi i cilësisë së ushqimit në Qendër Burimore
- Përmirësimi i nivelit të higjienës në shkolla



Në vitin 2018, me kërkesën e Grupit Avokues të fëmijëve me AK si dhe prindërve të fëmijëve me AK, FK është realizuar në sektorin e shëndetësisë, me qëllim të adresimit të çështjeve të identifikuara dhe përmirësimit të shërbimeve për fëmijët me AK. FK është realizuar në komunat target të projektit dhe ka përfshirë: QKMF (Prishtinë), QMF1 (Ferizaj) dhe QKMF (Gjakovë).

Rezultatet kryesore të FK në sektorin e shëndetësisë

- Ekspozimi i listës së medikamenteve esenciale në hapësirat e QMF si dhe orari i mjekëve dhe i ofrimit të shërbimeve shëndetësore si formë e transparencës ndaj komunitetit
- Sigurimi i qasjes fizike në QKMF Prishtinë dhe Gjakovë, ku si rrjedhojë e inicimit në kuadër të FK janë funksionalizuar ashensorët si dhe janë krijuar tualete të qasshme për PAK (Shih Annex D)
- Ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve lidhur me teknikat e komunikimit me fëmijët me AK si dhe specifikat e tyre në mbrojtje nga dhuna në familje
- Ngritja e kapaciteteve të stafit shëndetësor të vizitave mbi identifikimin e AK, të drejtat dhe shërbimet për fëmijët me AK
- Realizimi i hulumtimit mbi nevojat dhe koston financiare për sigurimin e qasjes nëpër institucionet shëndetësore në 3 komunat target, dhe ndarja e gjetjeve me drejtoritë përkatëse
- Përmirësimi i sinjalistikës/shenjzimit në QKMF Prishtinë si formë e lehtësimit të orientimit për personat me AK përmes tabelave orientuese (Shih Annex D)
- Informimi i prindërve lidhur me benefitet e parimit një mjek-një familje
- Dorëzimi i kërkesave për shtimin e medikamenteve të fëmijëve me AK në listën esenciale të medikamenteve
- Përpilimi i kërkesave për plotësimin e ekipit mobil dhe sigurimin e automjetit për vizitat në terren për fëmijët me AK
- Rritja e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve shëndetësore në komunat target lidhur me referimin e fëmijëve me AK



Në vitin 2019, FK është realizuar në sektorin e shërbimeve sociale. Në bashkëpunim të ngushtë me QPS, grupi avokues i fëmijëve dhe prindërit e tyre, kanë identifikuar si shumë të nevojshëm përmirësimin e shërbimeve sociale që ofrohen për fëmijët me AK, vetëdijësimin e komunitetit si dhe promovimin e kërimit të shërbimeve.

Rezultatet kryesore të FK në sektorin e mirëqenies sociale

- Ngritja e kapaciteteve të stafit mbi llojet e AK, teknikat e komunikimit me fëmijët me AK si dhe specifikat e fëmijëve me AK në mbrojtje nga dhuna në familje
- Rritja e bashkëpunimit të QPS-ve me OJQ-të relevante me qëllim të koordinimit të punës dhe shërbimeve për fëmijët me AK
- Krijimi i hapësirave miqësore për fëmijë në kuadër të QPS në Prishtinë (Shih Annex D)
- Realizimi i vizitave të rregullta në shtëpi nga ana e QPS në Prishtinë
- Sigurimi i automjetit për funksionalizimin e vizitave në terren për fëmijët me aftësi të kufizuara në QPS Mitrovicë
- Pilotimi i Kartës Sociale- Librezë për fëmijët me aftësi të kufizuara e cila përmban në vete format/dokumentet bazë të 3 sektorëve ku fëmijët me AK marrin shërbime: të mirëqenies, shëndetësisë dhe arsimit me qëllim të përcjelljes më të lehtë të progresit të fëmijë por edhe rritjes së transparencës nga ana e ofruesve të shërbimeve. Rritja e promovimit të shërbimeve dhe rolit të QPS nga vetë zyrtarët e qendrave
- Informimi i rregullt i prindërve dhe fëmijëve për shërbimet e ofruara nga QPS si dhe të drejtat e tyre
- Informimi i vazhdueshëm i nxënësve të shkollave në 4 komunat target mbi shërbimet dhe rolin e QPS në mbrojtjen e fëmijëve përmes sesioneve informuese dhe materialeve promovuese të zhvilluara
- Paraqitja vizuale e pakos së shërbimeve në QPS, në muret e qendrës, dhe versionet e tyre miqësore për fëmijë (Shih Annex D)

Duke marrë për bazë rezultatet e arritura përgjatë vitit të parë të implementimit të FK në sektorin e arsimit, si dhe nevojën e madhe të institucioneve arsimore për mbështetje, HANDIKOS në bashkëpunim me grupin Hëna dhe grupin avokues të prindërve, në vitin 2020, ka filluar procesin e FK në institucione tjera të arsimit të komunave target.



Rezultatet kryesore të FK në sektorin e arsimit II

- Mbështetja e krijimit të dhomës burimore në SHFMU “Hilmi Rakovica” Prishtinë (Shih Annex D)
- Rifunksionalizimi i ekipës vlerësuese komunale në Mitrovicë përmes kërkesave në kuadër të FK
- Krijimi i ekipit mbështetës brenda SHFMU “Migjeni”, i cili do t’i ndihmojë mësueseve mbështetëse në identifikim, planifikim, koordinim dhe mbështetje ndaj fëmijëve me AK.
- Sigurimi i transportit shtëpi-shkollë dhe anasjelltas për fëmijët me AK në 4 shkollat target, përmes informimit të ofruesve të shërbimeve dhe familjeve të fëmijëve me AK për të drejtën e transportit
- Trajnimi i 100 mësimeve mbi hartimin dhe implementimin e PIA si dhe pajisja e fëmijëve me PIA cilësorë të përpiluar përgjatë trajnimit në Gjakovë.
- Informimi i prindërve mbi rëndësinë e PIA, ekipës vlerësuese si dhe të drejtat nëpërmjet shpërndarjes së pakos informuese mbi të drejtat e fëmijëve me AK
- Mbështetja e shkollave target me material didaktik në funksion të mbështetjes së fëmijëve me AK
- Organizimi i orarit të seancave të fëmijëve me AK me mësuesen mbështetëse dhe njoftimi i prindërve lidhur me këto seanca në SHFMU “Hilmi Rakovica” në Prishtinë
- Rritja e bashkëpunimit me Handikos Gjakovë sa i përket ofrimit të shërbimeve për nxënësit që e kanë kaluar moshën ligjore për të qenë pjesë e SHFMU.
- Përmirësimi i kushteve higjienike të SHFMU “Migjeni”, përmes krijimit të checklistës për kontrollin e pastërtisë, si dhe sesioneve informuese me nxënës

Vlen të theksohet se të gjitha rezultatet e arritura përgjatë viteve në kuadër të proceseve të ndryshme të FK janë arritur përmes takimeve të vazhdueshme përcjellëse për vite me radhë, të cilat kanë fuqizuar tutje bashkëpunimin e HANDIKOS me institucionet përkatëse në funksion të përmirësimit të shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara. Nga diskutimet në fokus grupe dhe intervistat gjysmë të strukturuar me komunitetin dhe ofruesit e shërbimeve, kur janë pyetur për atë se çfarë është arritur përmes pjesëmarrjes në proceset e llogaridhënies sociale, nga të dyja palët është theksuar përmirësimi i shërbimeve në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies. Si komuniteti, respektivisht fëmijët me AK dhe prindërit e tyre, edhe ofruesit e shërbimeve (shkollat, QMF-të, QPS-të etj.) kanë shprehur që shërbimet janë përmirësuar dhe kjo formë e dialogut e ka strukturuar shumë bashkëpunimin, që nga identifikimi i problemeve për komunitetin e deri tek adresimi i përbashkët i tyre, përmes zhvillimit të planeve të veprimit dhe realizimit të aktiviteteve në funksion të përmirësimit të shërbimeve të identifikuara.



Prindërit dhe fëmijët:

“P.sh. ne kemi arritur që të sigurojmë transportin falas, pastaj kemi arrit që me përmirësu qasjen në tualet nëpër shkolla, i kena mbyll klasat e bashkangjitura, dhe i kena shndërruar në klasat burimore, kena vendos sinjalizime nëpër QKMF për shërbime tjera, që na ka dal prej takimeve kur i kena identifiku dhe prioritzu indikatorët.”

Ofruesit e shërbimeve:

“Me anë të FK, ne si ofrues të shërbimeve e kemi më të lehtë të i adresojmë problemet që komunitetet i kanë. Kjo na ka ndihmu edhe neve shumë që të i përmirësojmë shërbimet, sidomos me strukturu edhe na punën tonë. P.sh, na në shkollën tonë, përmes FK, kemi arrit që me i shtu tri mësuese mbështetëse për fëmijët me AK.”

“Në shkollën tonë, përmes FK, dhe bashkëpunimit me fëmijët me AK, prindërit e tyre dhe stafin e HANDIKOS, kemi siguruar transportin, kemi krijuar klasën burimore, kemi siguru materiale didaktike, e kena bo qasjen më të lehtë në tualet etj.”

“Në QKMF, kena vendos sinjalizime për qasjen në objekt si dhe kena kriju qasje më të lehtë. Mendoj që FK, na ka vetëdijësu edhe neve si ofrues për shërbimet dhe mundësitë e përmirësimit. Komuniteti është gjithmonë i hapur për të adresuar shqetësimet e tyre tek ne në QKMF dhe së bashku do të mundohemi të gjejmë zgjidhje.”

“Përmes FK, është rrit shumë bashkëpunimi me grupet avokuese të fëmijëve me AK, dhe si rezultat kemi punuar në promovimin e shërbimeve që ofrojmë ne si qendër për këta fëmijë. Shumë shpejt, në bashkëpunim me HANDIKOS ka me dal edhe një video tjetër promovuese për shërbimet që ofrohen këtu në QPS dhe çfarë ne si qendër për punë sociale (QPS) bëjmë për mbrojtjen e fëmijëve.”

Stafi implementues i HANDIKOS:

“Për ne si staf, rezultati kryesor është fuqizimi dhe përfshirja e fëmijëve me AK dhe prindërve të tyre, e veçanërisht vetëdijësimi për të drejtat e tyre në shërbime si dhe obligimet dhe përgjegjësitë që i kanë institucionet përkatëse. Për neve është mahnitëse të shohim progresin e këtyre fëmijëve dhe prindërve nga viti 2017 e deri më sot. P.sh. sot në asnjërën prej shkollave target, transporti më nuk është më problematik.”



2. ÇFARË NDIKIMI KA PASUR MEKANIZMI I FK NË FUQIZIM TË KOMUNITETIT DHE OFRUESVE TË SHËRBIMIT?

Rezultati 2.2.a: Organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) dhe Qendrat e rehabilitimit me bazë në komunitet (QRBK) kanë kapacitete për të përdorur dhe promovuar mjetet e llogaridhënies sociale për të mundësuar krijimin e sistemeve të përgjegjshme që konsiderojnë prioritetet e fëmijëve, dhe fëmijët, familjet dhe ofruesit e shërbimeve kuptojnë dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në dialogun e llogaridhënies sociale

Rezultati 2.2.b Fëmijët, familjet dhe ofruesit e shërbimeve kuptojnë dhe marrin pjesë aktive në dialogun e llogaridhënies sociale

Indikatori i Rezultatit 2.2	Po (sipas vlerësimit përfundimtar dhe raporteve)	Jo (sipas vlerësimit përfundimtar dhe raporteve)
# numri i komunave të përfshira në intervenime avokuese	✓	
# numri i familjarëve (duke përfshirë edhe fëmijët) që janë vetëdijesuar për rëndësinë e Dialogut të Llogaridhënies Sociale përmes OSHC-ve	✓	
# i intervenimeve të realizuara nga fëmijët dhe komuniteti	✓	
# i fëmijëve, familjeve, ofruesve të shërbimeve që marrin pjesë aktive në procesin e dialogut të llogaridhënies sociale	✓	
# i proceseve të llogaridhënies sociale të mbështetura/lehtësuara nga OSHC-të	✓	



Qëllimi i përgjithshëm i këtij rezultati është të kontribuojë në përfshirjen e fëmijëve me AK në procese të llogaridhënies sociale dhe sigurimin e shërbimeve specifike adekuate për fëmijët me AK. Një nga faktet kryesore që del nga rezultatet e këtij vlerësimi është se FK ka arritur që të kontribuojë në mënyrë të suksesshme në fuqizimin e fëmijëve me AK përmes përfshirjes në procese të llogaridhënies sociale dhe përmirësimit të shërbimeve specifike për ta. Në ndikimin që ka pasur projekti në përfshirjen e fëmijëve me AK në procese të llogaridhënies sociale, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve përmes dialogut dhe bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve , që është edhe qëllimi kryesor i FK, ky vlerësim është fokusuar të kuptojë domethënien dhe impaktin e këtij procesi për fëmijët dhe prindërit/kujdestarët ligjor të fëmijëve. Specifikisht, ky vlerësim ka synuar të kuptojë nivelin e vetëdijësisë në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procese të tilla dhe ngritjen e zërit për shqetësimet që ata kanë si dhe përpjekjet e tyre për të përmirësuar shërbimet në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale përmes FK dhe avokimit.

Përgjatë zhvillimit të fokus grupeve dhe intervistave , evidencat indikojnë një impakt pozitiv për fëmijët. Të gjithë fëmijët pjesëmarrës në fokus grup si dhe prindërit e tyre, mendojnë dhe janë të pajtimit që FK si mekanizëm i llogaridhënies sociale iu ka ndihmuar shumë për të kuptuar të drejtat që ata kanë, përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve si dhe mënyrën se si të ndikojnë në çështjet që ata i shqetësojnë apo shërbimet që ata duan të i përmirësojnë.

Si qëndron situata sa i përket këndvështrimit të fuqizimit të fëmijëve me AK në llogaridhënien sociale? Fakti që del nga ky këndvështrim është se FK u ka mundësuar anëtarëve të komuniteteve pjesëmarrëse të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me ofrimin e shërbimit. Kur u pyetën, “A jeni të kënaqur me mënyrën se si FK ju ka mundësuar që të përfshihenit në identifikimin e problemeve që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga ofruesit e shërbimeve?” në një nga diskutimet e fokus grupeve, anëtarët dhanë përgjigjet në përmbledhjen e mëposhtme:

“Përmes Fletënotimit Komunitar, ne kemi pasur mundësinë të shprehim shqetësimet dhe perspektivat tona për shërbimet që na ofrohen dhe po ashtu të bëjmë plane për të i përmirësuar ato” - (Fëmijë – anëtar i grupit Hëna)



“Fletënotimi Komunitar, na ka mundësuar të kuptojmë që ne duhet të ngrisim zërin për çështjet që na shqetësojnë dhe që të drejtat tona duhet dhe mund të zbatohen, dhe po ashtu që institucionet e kanë për obligim të zbatojnë të drejtat dhe ofrojnë shërbimet që na takojnë me ligj.” – (Fëmijë – anëtar i grupit Hëna)

Sa i përket rritjes së aftësive për të implementuar FK dhe adresuar çështjet që i shqetësojnë, qoftë fëmijët dhe prindërit e tyre apo edhe ofruesit e shërbimeve, të dhënat nga ky vlerësim indikojnë se FK ka ndikuar pozitivisht në një shkallë të lartë. Kur janë pyetur se: “A mendoni që janë rritur aftësitë tuaja për të implementuar FK për të adresuar problemet tuaja?” prindërit dhe fëmijët u përgjigjen si në përmbledhjen e mëposhtme:

“Më përpara nuk ka pasur shumë bashkëpunim, me shkollat apo qendrat e mjekësisë familjare apo punë sociale, tash bashkëpunimi është shumë më i mirë. FK, ka ndiku shumë në këtë aspekt. **(Fëmijë – anëtar i grupit Hëna)**

Ma herët, skena pas njohuri për FK, ankesat kanë qenë më shumë mes prindërve dhe nuk kanë shku kurrë më larg, por tani ne si këshill i prindërve me njohuritë dhe përvojën nga FK, e dijmë se si dhe ku me i adresu çështjet.” **(Prind i fëmijës me AK)**

“FK, na ka vetëdijesë neve si prindër shumë.” Dhe jo vetëm neve, por edhe fëmijët tanë. P.sh. fëmija im më nuk hesht, nëse një e drejt e tij cenohet. Ai e ngrit zërin dhe kërkon që të mos mohohet e drejta e tij. **(Prind i fëmijës me AK).**

Nën këtë objektivë, FK ka pasur për qëllim të krijojë bashkëpunim në mes të komuniteteve pjesëmarrëse (në këtë rast fëmijëve me AK dhe prindërve të tyre) me ofruesit e shërbimeve, që të diskutojnë shërbimet, përmirësimin e tyre si dhe shqyrtojnë dhe adresojnë kërkesat e komuniteteve. Evidencat nga ky vlerësim tregojnë që FK ka pasur suksese në krijimin e raporteve dhe praktikave bashkëpunuese ndërmjet ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve.

Takimi ballafaques i FK e ofron këtë hapësirë të bashkëpunimit. Ky është një hap i FK që sjell së bashku komunitetet pjesëmarrëse dhe ofruesit e shërbimeve për një diskutim të ndryshimeve konkrete që së



bashku mund të i implelementojnë menjëherë për të përmirësuar një shërbim. Ky diskutim është i bazuar në perceptimet dhe feedbackun në kualitetin, eficiencën dhe transparencën e shërbimeve.

Takimi ballafaques ka rritur aftësinë e komuniteteve për të dialoguar dhe influencuar ofruesit e shërbimeve, dhe nuk është për tu çuditur që kur janë pyetur anëtarët e komunitetit se “Çfarë ju pëlqen tek FK?” ata kanë thënë që FK ju pëlqen jo vetëm për faktin që ka krijuar hapësira për dialog por edhe që ka përmirësuar raportet me ofruesit e shërbimeve dhe ka ndihmuar që të arrihen ndryshimet e kërkuara. Më konkretisht, ata u shprehën si në vijim:

“FK, na ka mundësuar që të shprehim shqetësimet tona dhe të fëmijëve tanë. Më pëlqen, sepse i ka mundësuar edhe fëmijëve që të aftësohen dhe të kërkojnë llogari për të drejtat e tyre.”

“Përmes pjesëmarrjes në këtë proces, ne kemi krijuar raporte shumë të mira me shkollat, QKMF-në dhe QPS. Kjo ka qenë shumë e mirëseardhur për ne si shfrytëzues të shërbimeve (prindërit + fëmijët) që së bashku me i identifikojmë nevojat, me i bëjmë planet e veprimit dhe me i përmirësojmë shërbimet.” **(Prind i fëmijës me AK) & (Fëmijë – anëtar i grupit Hëna)**

Ndërkaq, ofruesit e shërbimeve shprehën se FK ka krijuar një formë të strukturuar të bashkëpunimit. Neve si mësues na ka ndihmu shumë FK, na ka rritur kapacitetin edhe njohuritë qysh me i përfshi fëmijët me AK, edhe përmes pjesëmarrjes tonë në FK e kësaj strukture punën tonë ma mire. Shume sene i kena ma të lehta, edhe ma lehtë për neve kur po përfshihet edhe prindi edhe fëmija **(Mësuese)**

FK, për neve si QKMF, ka qenë shumë e mirëseardhur sepse edhe neve na ka fuqizuar sa i përket edhe njohurive edhe mënyrës qysh mi trajtojmë kërkesat e fëmijëve me AK. P.sh. këtë vit skena pas mundësi me kërkuar buxhet ma shumë, por p.sh. vitin tjetër synojmë që me i përfshi fëmijët me AK ne buxhetimin e aktiviteteve të QKMF-së sonë. **(ZV. Drejtor në QKMF)**



3. SI KANË NDIKUAR INTERVENIMET E PROJEKTIT NË RRITJEN E PJESËMARRJES SË FËMIJËVE ME AK NË PROCESET E VENDIMMARRJES DHE FUQIZIMIT TË ROLIT TË TYRE NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE?

REZULTATI 2.3: GRUPET E UDHËHEQURA NGA FËMIJËT KANË KAPACITETE QË MUNDËSOJNË PJESËMARRJEN E TYRE KUPTIMPLOTE NË PROCESET VENDIMMARRËSE – FORCIMI I GRUPEVE AVOKUESE TË UDHËHEQURA NGA FAK (GA-FAK) – HËNA

Indikatori i Rezultatit 2.2	Po (sipas vlerësimit përfundimtar dhe raporteve)	Jo (sipas vlerësimit përfundimtar dhe raporteve)
# punëtorive për të fuqizuar grupet e avokimit të udhëhequra nga fëmijët më AK (Grupi Hëna)	✓	
# i personave që marrin pjesë në punëtori që synojnë të forcojnë GA-FAK	✓	
# i iniciativave të mbështetura avokuese të udhëhequra nga fëmijët (ndërhyrjet e avokimit të OPAK-ve Lokale, Grupeve të udhëhequra nga FAK dhe Grupeve të Avokimit të Prindërve)	✓	
# i punëtorive të përbashkëta të GA-FAK	✓	
# i GA-FAK funksionale	✓	
# i takimeve të Grupit Hëna	✓	
# mentorëve të trajnuar	✓	



Qëllimi i përgjithshëm i këtij rezultati ka qenë krijimi, funksionalizimi dhe përkrahja e vazhdueshme e Grupit Avokues të Udhëhequr nga Fëmijëve me AK në pjesëmarrje në procese vendimmarrëse. Konkretisht përmes këtij rezultati është synuar fuqizimi i kapaciteteve të Grupit Avokues të Udhëhequr nga Fëmijët me AK (Hëna) me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes kuptimplote në procese vendimmarrëse. Ky vlerësim ka synuar të kuptojë efektin që kanë pasur intervenimet e këtij projekti në rritjen e kapaciteteve dhe pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në procese vendimmarrëse dhe në aftësinë për të ndikuar në procese që prekin të drejtat e tyre.

Të arriturat kryesore të Grupit Avokues të Fëmijëve me AK (Hëna) gjatë vitit 2017

- Krijimi dhe funksionalizimi i Grupit Avokues të Udhëhequr nga Fëmijët me AK me përbërje nga fëmijë të tri komunave të targetuara (Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë)
- Zhvillimi i rregullores për funksionimin e GA-FAK, strategjisë dhe planeve të veprimit
- Realizimi i punëtorive formale dhe jo-formale me qëllim të adresimit të nevojave dhe aktiviteteve të projektit
- Realizimi i iniciativave avokuese për krijimin e klasave burimore
- Realizimi i konferencës për përfshirjen e fëmijëve me AK në arsim

Të arriturat kryesore të Grupit Avokues të Fëmijëve me AK (Hëna) gjatë vitit 2018

- Pjesëmarrja në procese të llogaridhënies sociale në komunat përkatëse
- Realizimi i kampanjave avokuese mbi rëndësinë e implementimit të parimit një mjek-një familje dhe adresimit të nevojave të fëmijëve me AK në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor
- Realizimi i kampanjave avokuese mbi rëndësinë e qasjes fizike për fëmijët me AK
- Realizimi i takimeve me nivelin qendror (Ministrisë) dhe atë lokal (Komunës) (Shih Annex D)
- Ngritja e kapaciteteve të fëmijëve përmes trajnimeve/punëtorive të organizuara nga HANDIKOS mbi: të drejtat e fëmijëve (KDF); qytetaria aktive & pjesëmarrja: buxheti në nivel komunal etj.

Është e rëndësishë së veçantë për tu përmendur se si rezultat i formësimit dhe ngritjes së kapaciteteve avokuese dhe pjesëmarrëse të Grupit Hëna, fëmijët anëtarë të grupit Hëna në komunat përkatëse, janë angazhuar, kanë avokuar dhe kanë marrë pjesë në procese të rëndësishme vendimmarrëse dhe edhe në shumë iniciativa të tjera jashtë projektit, si p.sh.:



- Pjesëmarrja në debate publike
- Pjesëmarrja në dëgjime buxhetore të komunës
- Pjesëmarrja në takimin e shënimit të Ditës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Bruksel
- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i fëmijëve me AK në Kuvendin e Republikës së Kosovës në shënimin e ditës së Konventës së të drejtave të fëmijëve, etj.

Të arriturat kryesore të Grupit Avokues të Fëmijëve me AK (Hëna) gjatë vitit 2019

- Realizimi i iniciativave avokuese me qëllim të promovimit të mbrojtjes së fëmijëve dhe qeverisjes së të drejtave të fëmijëve në komunat e targetuara me fokus të veçantë në:
 - Promovimin e pakos së shërbimeve sociale që ofrohen në kuadër të QPS. Në kuadër të kësaj iniciative nga Grupi Hëna, komuniteti, shkollat dhe palët e tjera të interesit janë njoftuar për shërbimet që ofrohen në QPS dhe janë shpërndarë broshura dhe materiale të tjera informuese.
 - Promovimi i rolit të QPS në mbrojtjen e fëmijëve. Në kuadër të këtij aktiviteti po ashtu është realizuar fushatë vetëdijësuese për rolin që QPS ka në mbrojtjen e fëmijëve.
 - Zhvillimi i kampanjës mbi rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitete fizike në shkolla.
 - Zhvillimin e muralit me tematikë të mbrojtjes së fëmijëve- STOP dhunën ndaj fëmijëve! (Shih Annex D)
 - Krijimi i tualetit të qasshëm në shkollën “Ismail Qemali” përmes një miniprojekti të fituar nga vetë grupi
- Anëtarët e Grupit Hëna morën pjesë në shumë ngjarje/konferenca lokale, nacionale dhe ndërkombëtare duke përfaqësuar kështu zërin e të gjithë fëmijëve me AK
- Ngritja e kapaciteteve në avokim, komunikim, prezantim, menaxhim të stresit përmes trajnimeve të ofruara nga HANDIKOS. Të gjitha këto trajnime i kanë shërbyer anëtarëve për të zhvilluar planet e veprimit, strategjinë, për të komunikuar nevojat dhe adresuar sfidat, dhe natyrisht për të realizuar të gjitha aktivitetet avokuese që përfundimisht kanë ndikuar në përmirësimin e shërbimeve.
- Realizimi i takimeve të rishikimit të planeve të veprimit dhe diskutimit të aktiviteteve, sfidave dhe planeve për vitin 2020.



Të arriturat kryesore të Grupit Avokues të Fëmijëve me AK (Hëna) gjatë vitit 2020

- Realizimi i kampanjës “Unë, pa dhunë” në bashkëpunim me grupin ROR, me qëllim të vetëdijësimit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje gjatë pandemisë Covid-19
- Pajisja e parkut “Liria” në Ferizaj me luhatëse të qasshme për fëmijët me AK, si formë e promovimit të rëndësisë së krijimit të mundësive të barabarta për lojë, si një ndër të drejtat bazike të fëmijëve (Shih Annex D)
- Zhvillimi dhe publikimi i revistës online Hëna me qëllim të promovimit të punës së grupit Hëna, ngritjes së zërit të fëmijëve me AK dhe rritjes së vetëdijes së shoqërisë në lidhje me të drejtat e fëmijëve me AK
- Avokimi për sigurimin e materialeve didaktike për shkolla
- Pjesëmarrja e anëtarëve të Grupit Hëna në punëtorinë tre ditore me qëllim të ngritjes së kapaciteteve mbi avokimin, duke përfshirë këtu teknikat për identifikim, prioritizim dhe adresim të çështjeve që i preokupojnë ata.
- Anëtarësimi i anëtarëve të grupit Hëna në grupe të tjera avokuese për të drejtat e fëmijëve si ROR, Asamblëtë Komunale si dhe organizatat rinore.

Të arriturat kryesore të Grupit Avokues të Fëmijëve me AK (Hëna) gjatë vitit 2021

- Zhvillimin i strategjisë 2022-2025 dhe planit të ri të veprimit të grupit Hëna
- Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të grupit përmes trajnimit të organizuar nga HANDIKOS mbi teknikat e mentorimit
- Realizimi i kampanjës “Bëhu mburoja ime!” me qëllim të promovimit të raportimit të dhunës ndaj fëmijëve
- Realizimi i kampanjës “Pa asistent unë jam jashtë shkollës”, në kuadër të të cilës fëmijët përpos angazhimit në zhvillimin e videos informuese, kanë mbajtur edhe fokus grupe me prindër me qëllim të identifikimit të nevojave të cilat pastaj i kanë adresuar tek përfaqësuesit e DKA-ve në 4 komnat, si dhe tek Ministria e Arsimit përmes një takimi të përbashkët ku edhe kanë marrë zotimin për angazhimin e asistentëve nga ministria.
- Realizimi i kampanjës “Respekto të drejtën për qasje, TI e ke obligim!” në bashkëpunim me ROR dhe Asamblenë Komunale të Fëmijëve, me qëllim të promovimit të UA 33/2007, në kuadër të të cilës fëmijët gjithashtu kanë zhvilluar takime me drejtoritë relevante ku edhe kanë dorëzuar kërkesat e tyre për respektim të këtij udhëzimi përgjatë ndërtimit të çdo objekti.
- Krijimi i hapësirave miqësore në kuadër të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë,



Realizimi i punëtorisë së Grupit Hëna, prindërve dhe HANDIKOS ku u prioritzuan çështjet si:

- Identifikimi i anëtarëve të rinj të grupit
- Trajnimi i mentorshit për anëtarët e Grupit Hëna mbi 15 vjeç
- Pjesëmarrja në dëgjimore publike/ buxhetore
- Realizimi i takimit me përfaqësuesit e Drejtorisë Komunale për Rini, Kulturë dhe Sport me qëllim të përfshirjes së planit të veprimit të Grupit Hëna në kornizën e planit të veprimit për rininë në nivel lokal
- Takimet e përbashkëta me grupin RoR dhe fëmijët e Asamblesë Komunale

Përgjatë këtij viti, jashtë angazhimeve në kuadër të projektit, fëmijët e grupit Hëna gjithashtu janë angazhuar në përfaqësimin e fëmijëve me AK në punëtori, diskutime dhe kampanja të ndryshme të organizuara nga Save the Children si dhe organizata dhe institucione të tjera relevante, duke përfaqësuar kështu zërin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe lobuar për mbrojtje të të drejtave të tyre.

Për të i dhënë një përgjigje konkrete pyetjes përkatëse të vlerësimit: "Si kanë ndikuar intervenimet e projektit në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në proceset e vendimmarrjes dhe fuqizimit të rolit të tyre në mbrojtjen dhe avokimin e të drejtave të fëmijëve?" - është e qartë nga gjetjet e këtij vlerësimi që aktivitetet avokuese dhe pjesëmarrëse të fëmijëve të këtij projekti patën sukses të kënaqshëm në rritjen e njohurive civile dhe në fuqizimin e fëmijëve për të monitoruar ofrimin e shërbimeve dhe kërkuar përmirësimin e tyre; në fuqizimin e kapaciteteve të tyre për të identifikuar dhe artikulluar në mënyrë sistematike, të besueshme dhe objektive çështjet me interes për ta; dhe në rritjen e aftësisë së tyre për të dialoguar dhe influencuar zyrtarët qeveritarë.

Përmes këtyre intervenimeve është rritur angazhimi i fëmijëve me AK në iniciativa avokuese me synim të ndikimit në adresimin e problemeve dhe sfidave me të cilat ata përballen. Intervenime të tilla u realizuan në shumë forma, duke përfshirë fushatat mediatike, lobimin komunal dhe parlamentar, takime lobuese me ofruesit e shërbimeve dhe politikëbërësit, hartimin e reformave ligjore dhe zhvillimin e planeve të veprimit dhe strategjive që adresojnë problemet specifike të fëmijëve me AK.

Në pyetjen që iu është parashtruar se: **"A mendoni që zëri i komuniteteve pjesëmarrëse dëgjohe më shumë në proceset e vendim-marrjes dhe atë të politikave pas pjesëmarrjes në aktivitetet e implementuara nga ky projekt?"**



Shumica e pjesëtarëve të komunitetit, fëmijët me AK, prindërit e fëmijëve me AK, stafi HANDIKOS, dhe ofruesit e shërbimeve, u përgjigjën në mënyrë afirmative. Ata theksuan që përmirësimi i shërbimeve që është arritur tregon që zëri i tyre është dëgjuar.

Fëmijët:

“Përmes pjesëmarrjes sonë në këto aktivitete, zëri ynë është dëgjuar dhe ne kemi arritur të ndryshojmë shumë gjëra. Ne e bëjmë këtë përmes avokimit dhe pjesëmarrjes në kuadër të Grupit Hëna.

Në fillim, ne nuk kemi pasur njohuri, pastaj kemi mësuar shumë për të drejtat tona, dhe jemi aftësuar për të avokuar për të drejtat tona. Në krahasim, me situatën në fillim, kur sapo jemi krijuar si grup, tani mund të themi që zëri jonë dëgjohej shumë më shumë, jemi pjesëmarrës në shume procese. Ne e kemi edhe strategjinë dhe planin e veprimit me prioritetet e caktuara nga ne si grup.”

“Ne mendojmë që ndoshta duhet përfshirë edhe më shumë, që të dëgjohej zëri jonë edhe më shumë. P.sh., vitin tjetër mendojmë të jemi pjesë e dëgjimeve buxhetore”

Është e rëndësishme të theksohet se si aktivitetet avokuese dhe pjesëmarrja e fëmijëve në procese vendim-marrëse dhe në ato të FK, ka ndikuar dukshëm në formimin e kapaciteteve të fëmijëve me AK për të ndikuar në çështje me interes për ta. Kjo jo vetëm nga rezultatet direkte të këtij projekti por edhe përmes pjesëmarrjes së anëtarëve të Grupit Hëna në shumë aktivitete tjera jashtë projektit, dhe përmirësimit të shërbimeve apo edhe inicimit të ndonjë shërbimi të ri që është konsideruar i nevojshëm. Vlen të përmenden këtu se duke ngritur zërin dhe lobuar për të drejtat e tyre fëmijët me aftësi të kufizuara kanë kontribuar direkt në zbatimin e të drejtave të tyre, si p.sh për qasje fizike në shkollë apo edhe luftimin e diskriminimit në shkollë- gjë e cila përfshin edhe një ndër qëllimet kryesore të objektivës e që po ashtu reflekton qëndrueshmërinë e aktiviteteve të këtij projekti.

“Djali im është pjesë e grupit Hëna, dhe ai është aftësuar shumë për të avokuar për të drejtat e tij. Së bashku me anëtarët e grupit, ai mundohet me ndiku në përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen atij dhe fëmijëve të tjerë me AK”. Djali im e lufton sot diskriminimin kudo, p.sh., në shkollë, kur ai është quajtur si i paaftë, ai ka reaguar dhe ka shprehur shqetësimin e tij tek autoritet e shkollës për diskriminimin që i është bërë. Jam



shumë e lumtur që i del zot vetes dhe fëmijëve të tjerë. E gjithë kjo, falë të gjitha njohurive dhe kapaciteteve që ne bashkërisht i kemi marrë nga pjesëmarrja në këto aktivitete. (Prind i fëmijës me AK)

Fëmijët e grupit Hëna:

“Në shkollën ku unë shkoj e kam pas të pamundur me shku fillimisht, sepse ska pas qasje fizike për mu. Unë përmes pjesëmarrjes në grupin Hëna, kam kuptu që unë duhet me ngrit zërin për problemet mia, dhe kështu kam vepruar dhe kam arritur që të krijohet qasja fizike për mua dhe fëmijët e tjerë me AK në shkollën tonë.”

Stafi implementues i HANDIKOS:

Si suksesin më të madh ne e shohim grupin Hëna. Ky grup është formuar si rezultat i nevojës për të dëgjuar zërin e tyre për shqetësimet që ata kanë. Ne jemi shumë të kënaqur me progresin e tyre, nga 2017 e deri tani. Anëtarët e grupit Hëna kanë qenë personat kyç konsultativ në të gjitha rishikimet e projekteve dhe vlerësimit të nevojave.

Projekti në përgjithësi, duke përfshirë procesin e FK si dhe aktivitetet e grupit avokuse të fëmijëve Hëna, konsiderohet si një projekt mjaft relevant, duke marrë parasysh faktin se të gjithë pjesëmarrësit në këtë vlerësim ishin shumë të kënaqur me aktivitetet e FK.

Niveli i pëlqimit apo kënaqësisë me aktivitetet e FK dhe pjesëmarrjes së Fëmijëve			
Pjesëmarrësit	Të kënaqur	Të pakënaqur	Total
Fëmijët me AK	8		8
Prindërit e Fëmijëve me AK	3		3
Ofruesit e shërbimeve	10		10



4. SA TË QËNDRUESHME JANË AKTIVITETET E FK DHE PJESËMARRJES SË FËMIJËVE ME AK?

A do të jenë rezultatet e FK dhe pjesëmarrjes së fëmijëve të qëndrueshme?
Një fakt që ka dal nga ky vlerësim është që anëtarët e komunitetit pjesëmarrës në FK, organizatat partnere implementuese dhe ofruesit e shërbimeve, do të gëzojnë përfitimet që vijnë me rritjen e njohurive të tyre qytetare, kapacitete të fuqizuara për të monitoruar ofrimin e shërbimeve; identifikimin dhe artikulin në mënyrë objektive të çështjeve me interes për ta; rritjen e aftësisë dhe vetëbesimit dhe besimit në grup për të dialoguar dhe influencuar zyrtarët qeveritarë.

Të dhënat nga ky vlerësim tregojnë se shumica e anëtarëve të komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve të cilët kanë marrë pjesë në aktivitetet e FK synojnë të vazhdojnë të rriten në kompetencën e tyre qytetare.

Planet për të mbajtur të qëndrueshme rezultatet e FK dhe pjesëmarrjes së fëmijëve	
Pjesëtarët e komunitetit	✓ Ata synojnë të mbështesin dhe përdorin procesin e FK ✓ Ata synojnë të përdorin procesin e FK në monitorimin e shërbimeve ✓ Ata vazhdojnë të edukojnë njëri tjetrin në të drejtat ✓ Ata synojnë të vazhdojnë bashkëpunimin me ofruesit e shërbimeve në përmirësimin e shërbimeve ✓ Ata synojnë të angazhohen në mënyrë aktive në monitorimin e politikave dhe të zgjerojnë angazhimin edhe në përfshirjen e shërbimeve të tjera
Ofruesit e shërbimeve	✓ Ata synojnë të vazhdojnë inkurajimin e dialogut dhe bashkëpunimit me shfrytëzuesit e shërbimeve ✓ Ata synojnë të jenë transparent në punën e tyre ✓ Ata synojnë të edukojnë dhe informojnë shfrytëzuesit e shërbimeve për shërbimet që ata i ofrojnë ✓ Ata synojnë të vazhdojnë diskutimet me shfrytëzuesit e shërbimeve në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë



HANDIKOS

- ✓ Ata synojnë të transferojnë këto kompetenca tek komuniteti
- ✓ Ata synojnë të replikojnë dhe promovojnë projektin në sa më shumë komuna dhe institucione tjera
- ✓ Ata synojnë të vazhdojnë të ndihmojnë komunitetet në çdo hap që ata kanë nevojë

5. ÇFARË MËSIMESH OFRON PËRVOJA E PROJEKTIT TE PALËT E INTERESUARA?

Ky projekt përdori disa strategji, qasje dhe mjete për të arritur rezultatet që synonte të arrinte.

Bazuar në faktet e paraqitura në faqet dhe paragrafët e mësipërm, ky vlerësim tregon se nga këto strategji, qasje dhe mjete ishin të suksesshme në arritjen e asaj që duhej të arrinin. Prandaj, përvoja e FK dhe pjesëmarrjes së fëmijëve ofron disa mësim.

Së pari, përvoja e këtij projekti konfirmon faktin se FK nuk është vetëm një mjet i fuqishëm monitorimi i llogaridhënies i bazuar në komunitet por edhe një mjet i fuqishëm për fuqizimin e qytetarëve. Për shkak të kësaj, përvoja e FK duket se mbështet dy hipoteza të ngulitura në strategjinë e këtij intervenimi:

(1) nëse mbajtësit e të drejtave bëhen konfident në vetvete, atëherë ata do të angazhojnë bartësit e detyrave, dhe (2) nëse mbajtësit e të drejtave do të angazhojnë bartësit e detyrave, atëherë bartësit e detyrave do të bëhen të përgjegjshëm dhe transparentë.

Së dyti, përvoja e FK ofron mësim se implementimi i procesit të FK arrin rezultate më të mira, duke qenë një proces që zbatohet hap pas hapi, dhe ku një hap ndërton tjetrin. Nëse ndonjëri nga pjesëmarrësit në proces, është shkëputur nga procesi, atëherë kjo ka ndikuar në vazhdimësinë dhe kualitetin e rezultateve të FK.



Së treti, përfshirja e fëmijëve për avokimin dhe adresimin e çështjeve që janë me interes për ta, e garanton impaktin dhe cilësinë si dhe sa e rëndësishme është mundësia për të i vlerësuar shërbimet dhe për të gjetur mundësi për dialog dhe bashkëpunim. Përfshirja e fëmijëve me AK, anëtarëve të komuniteteve të tyre dhe organizatave lokale në çdo fazë të iniciativave avokuese jo vetëm që sjell besueshmëri më të madhe por mund të ndihmojë në konsiderimin e aspektit politik ose situatave të ndryshme kulturore apo sociale, dhe përfundimisht fuqizimin e personave që do të përfitojnë më shumë nga ndryshimet që janë kërkuar. Një mësim shumë i rëndësishëm që del nga implementimi i këtij projekti është se rezultatet e suksesshme janë arritur në radhë të parë nga një avokim i koordinuar në nivele të ndryshme, përdorimi i formave të ndryshme të avokimit si dhe përfshirja e fëmijëve në çdo fazë të iniciativave, duke filluar nga identifikimi i qëllimit, analiza e situatës dhe dokumentacionit relevant, identifikimi i targeteve dhe personave/institucioneve me ndikim, vendosja e qëllimit për ndryshimin, identifikimi i ngjarjeve dhe mundësive, krijimi i planeve të veprimit, monitorimi i aktiviteteve dhe modifikimi apo përditësimi.



KUFİZİMET

Vlerësimi final i objektivës së dytë është përballur me tri sfida kryesore. Sfida e parë ka qenë metodologjike. Dizajni dhe metodologjia e këtij ka qenë kryesisht kualitative, duke përdorur Fokus Grupet dhe intervistat për mbledhjen e të dhënave primare. Boshllëqet e të dhënave statistikore të pa adresuara në kohën e përcaktimit të vlerësimit fillestar (baseline) kanë penguar domosdoshmërisht krahasimin bazë-përfundim të indikatorëve dhe kufizoi në një farë mase paraqitjen e rezultateve kuantitative. Një kufizim tjetër domethënës që e pengon paraqitjen më të qartë dhe më të lehtë të arritjes së rezultateve të synuara është numri i madh i indikatorëve, ndryshueshmëria e disa prej tyre në propozimet nga viti në vit, dhe pamundësia për të i matur disa prej tyre.



REKOMANDIMET

Duke qenë se ndër principet e projektit të promovimit të mbrojtjes së fëmijëve në të gjitha mjediset është fuqizimi, dhe ndër objektivat është edhe promovimi i modeleve të fuqizimit, HANDIKOS duhet të promovojë FK në të gjitha projektet dhe iniciativat. Rezultatet e implementimit të FK dhe opinionet e atyre që kanë marrur pjesë në këtë vlerësim tregojnë që FK nuk është vetëm një mjet efektiv i monitorimit të llogaridhënies i bazuar në komunitet, por edhe një mjet shumë i përshtatshëm për fuqizim efektiv të komunitetit.

Kushdo që vendos të përdorë FK duhet të ruajë me xhelozi vazhdimësinë gjatë ekzekutimit të procesit të FK. Përvoja tregon se procesi FK arrin rezultate më të mira kur i njëjti grup zbatuesish qëndrojnë gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit. Kur një anëtar i stafit të një prej organizatave partnere zbatuese u la apo disa nga anëtarët e komunitetit apo ofruesit e shërbimeve u larguan, kjo ndikoi deri diku në vazhdimësinë dhe cilësinë e rezultateve të procesit FK.

Projektet duhet të ndërmerren pasi të jetë bërë një bazë për të përcaktuar treguesit dhe vlerat bazë që më pas ndihmojnë në përcjelljen e progresit gjatë jetës së projektit.

Ndonëse, objektiva kryesore ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha mjediset përmes promovimit të mekanizmave të llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në procese vendimmarrëse dhe udhëheqje të iniciativave avokuese, dhe kjo është arritur përmes aktiviteteve të projektit qoftë në mënyrë direkte apo indirekte, rekomandohet që fokusi i aktiviteteve të jetë më drejtpërdrejt i përfshirë në aspektet e mbrojtjes së fëmijëve me AK në mjedise të ndryshme.

Përmbledhja e procesit të FK dhe modeleve të pjesëmarrjes së fëmijëve me AK në module, dhe sipas mundësive akreditimi apo institucionalizimi i tyre.

Realizimi i një takimi përmbyllës të projektit ose tryezë të rrumbullakët me partnerët kryesorë ndërinstitutionalë, për të ndarë gjetjet nga vlerësimi përfundimtar dhe për të shtyrë iniciativat institucionale që përsërisin ose integrojnë qasjen e FK si mjet i llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në shërbimet ekzistuese ose ato të reja.



Zgjerimi i rrjetit të Grupit Hëna edhe në komuna të tjera, dhe krijimi i një qendre ku të gjitha grupet koordinohen për një strategji të përgjithshme avokuese në nivel vendi por edhe në krijimin e planeve komunale varësisht nga nevojat e identifikuar.

Hartëzimi i komunitetit - kur planifikohen planet e veprimit duhet të përfshijnë hartën e komunitetit si pjesë e studimit bazë për të identifikuar segmentet ose institucionin me ndikim të komunitetit përreth. Kjo nënkupton edhe realizimin e një studimi bazë, që në vijim do të u ndihmonte anëtarët e grupit Hëna në krahasimin me rezultatet e një vlerësimi përfundimtar.

Ngritja e kapaciteteve të Grupit Hëna në monitorim dhe vlerësim, dhe po ashtu vendosje të indikatorëve. Një theks i veçantë të i vendoset edhe monitorimit të aktiviteteve avokuese, aktiviteteve të planit të veprimit si dhe realizimit të tyre nga ana e përgjegjësve duke përdorur këtu edhe përvojat me mekanizmat e procesit të llogaridhënies sociale.

Krijimi i një doracaku që do të reflektonte përvojën dhe aktivitetet e realizuara nga Grupi Hëna, mënyrën e avokimit, rezultatet që janë arritur dhe udhëzime se si të avokohet për të drejtat e fëmijëve me AK dhe si të përmirësohet pjesëmarrja e fëmijëve me AK në procese vendimmarrëse, duke pasur fëmijën në qendër dhe duke konsideruar qasje miqësore. Një gjë e tillë do të mundësonte edhe replikimin e një modaliteti të tillë edhe në mjedise tjera apo edhe komuna apo vende tjera.

Sa i përket rekomandimeve që kanë të bëjnë me strukturën e projekt propozimeve që kanë ndikuar edhe në paraqitjen e rezultateve në këtë raport vlerësues rekomandohet:

- Zhvillimi i kornizave logjike me numër më të vogël të indikatorëve dhe po ashtu indikator SMART.
- Zhvillimi i një studimi bazë me targete të specifikuar që do të mundësonte krahasimin me raportin vlerësues në përfundim të projektit
- Një formë më e strukturuar e raportimit narrativ dhe po ashtu atij të indikatorëve



ANEKSET

ANEKSI A

Vlerësimi final i FK dhe pjesëmarrjes së fëmijëve

Udhëzues standard i diskutimit të fokus grupit me Prindërit dhe Fëmijët

1. A janë rritur njohuritë e juaja rreth FK dhe llogaridhënies sociale pas pjesëmarrjes suaj në implementimin e FK?
2. Në cilin sektor të implementimit të FK keni marrë pjesë?
3. A jeni të kënaqur më mënyrën se si FK ju ka mundësuar juve që të përfshiheni në identifikimin e problemeve që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga ofruesit e shërbimeve?
4. A mendoni që janë rritur aftësitë tuaja për të implementuar FK për të adresuar problemet tuaja?
5. Gjatë këtij procesi ju keni identifikuar problemet dhe keni formuluar indikatorët për ato problematika, pastaj edhe planet e veprimit për të adresuar çështjet e identifikuara? A jeni duke përdorur në mënyrë aktive dhe efektive këto informacione për të influencuar vendimet apo politikat që udhëheqin shërbimet që iu ofrohen juve?
6. A mund të na jepni ndonjë shembull të ndonjë shërbimi që është përmirësuar si rezultat i pjesëmarrjes në FK? Nëse po çfarë përmirësimesh?
7. Në mendimin tuaj, a mendoni se zëri juaj në vendim-marrje dhe në përmirësimin e shërbimeve tani dëgjohet më shumë pas pjesëmarrjes në FK?
8. Çfarë keni mësuar nga ky proces?
9. A mendoni që FK është një mekanizëm efektiv për të përfshirë apo angazhuar qytetarët apo shfrytëzuesit e shërbimeve në përmirësimin e shërbimeve apo vendim-marrje?
Nëse po Pse?
Nëse jo Pse?
Nëse Po, si do ta promovoni përdorimin e FK?
10. Çfarë ju pëlqen tek FK? Çfarë nuk ju pëlqen tek FK?
11. Si pjesë e aktiviteteve të HANDIKOS, a ndjeheni se pjesëmarrja juaj në procese të rëndësishme për ju, p.sh. në shërbimet që ju ofrohen është rritur?



12. A ndjeheni se zëri juaj dëgjohej më shumë?
13. A mund të përmendni ndonjë shërbim që është përmirësuar ose është shtuar si shërbim i ri si rezultat i pjesëmarrjes suaj në vendime?
14. Si është raporti juaj me ofruesit e shërbimeve në raste kur konsultoheni për vendime që ju prekin juve?
15. Ju si grup udhëheqës, si e praktikoni punën tuaj, p.sh., si angazhoheni për një çështje që ka të bëjë me ju dhe dëshironi të jepni mendimet tuaja dhe ndikoni në atë shërbim?
16. A mendoni që përmes aktiviteteve të këtij projekti, ju tashmë jeni të aftë të udhëhiqni grupet tuaja dhe adresoni çështjet si dhe të ndikoni në vendim-marrje?
17. A mendoni se duhet ndryshuar diçka apo shtuar për të rritur kapacitetet tuaja?

ANEKSI B

Udhëzues standard i diskutimit të fokus grupit dhe intervistave me Ofruesit e Shërbimeve/Vendim-marrësit

1. A jeni të kënaqur me mënyrën se si FK ju ka ndihmuar që të punoni së bashku me shfrytëzuesit e shërbimeve për të adresuar shqetësimet e ngritura nga ata?
Nëse po çfarë ju bën të kënaqur?
Nëse jo, çfarë ju bën të pakënaqur?
2. A keni më shumë njohuri rreth llogaridhënies sociale dhe FK, pas pjesëmarrjes tuaj në këtë proces?
3. A mendoni se shfrytëzuesit e shërbimeve janë të përfshirë në mënyrë efektive në adresimin dhe monitorimin e shërbimeve
4. A mund të na jepni ndonjë shembull të ndonjë shërbimi që është përmirësuar si rezultat i FK?
5. Në mendimin tuaj a mendoni se FK ka ndihmuar FAK dhe familjet e tyre për të ngritur zërin për çështjet që i shqetësojnë ata?
6. Çfarë keni mësuar nga ky proces?
7. Cila është mënyra për krijuar qëndrueshmëri të rezultateve që keni arritur në këtë proces?



8. A mendoni që FK është një mekanizëm efektiv për të përfshirë apo angazhuar qytetarët apo shfrytëzuesit e shërbimeve në përmirësimin e shërbimeve apo vendim-marrje?

Nëse po Pse?

Nëse jo Pse?

9. Nëse po, si do ta promovoni përdorimin e FK?

10. Cfarë ju pëlqen tek FK? Cfarë nuk ju pëlqen tek FK?

ANEKSI C

Udhëzues standard i diskutimit të fokus grupit me Stafin

1. Cili ka qenë roli juaj dhe në cilat faza jeni përfshirë?
2. Cila mendoni që është objektiva më e madhe që e keni arritur
3. A ju duket juve si një mjet i përshtatshëm dhe që deri diku është arritur qëllimi?
4. Si e shihni angazhimin e prindërve dhe fëmijëve dhe ofruesve të shërbimit?
5. A mendoni se të gjithë fëmijët kanë qenë të përfshirë mjaftueshëm dhe kanë përfituar nga pjesëmarrja në këto aktivitete? Cilat do të ishin sugjerimet tuaja për të i bërë ata që të përfshihen më shumë?
6. Si e shihni qëndrueshmërinë e këtij procesi?
7. Si mendoni ju që ka shkuar ky proces? Çfarë ka shkuar mirë e çfarë jo mirë?
8. Çfarë gjera mund të bënte projekti më mirë?
9. Çfarë keni mësuar nga ky projekt dhe çfarë rekomandime keni për të ardhmen?



ANEKSI D

Rezultatet e arritura në kuadër të procesit të fletënotimit komunitar dhe punës me grupin “Hëna”



Klasa burimore SHFMU Ahmet Hoxha 2



Toaleti i qasshëm - SHFMU Ismail Qemali



Klasa burimore SHFMU Ahmet Hoxha



Ashensori- QKMF Gjakovë





Sinjalistika- QKMF Prishtinë

Hapësirat miqësore QPS 1





Hapësirat miqësore QPS 3



Hapësirat miqësore QPS 4





Paraqitja vizuale e shërbimeve dhe rolit të QPS



Klasa burimore- SHFMU Hilmi Rakovica



Klasa burimore- SHFMU Hilmi Rakovica



Murali STOP dhunës ndaj fëmijëve me AK



